



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

**Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Gusht 2024**

**Data 28.08.2024 ora 15:00.**

**Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.**

**Rendi i dites:**

- 1.Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.46 datë 13.06.2023, mbi zgjedhjen e zëvendës kryetarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.
- 2.Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.69 datë 28.09.2023, për ngritjen e komisioneve të Këshillit Bashkaik Vau Dejës.
3. Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2024.
- 4.Projekt vendim për dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurimit , me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 1 ha pjesë e pasurisë nr.22, Zk nr. 1100, e llojit “Kullotë”, në fshatin Barbullush, pronë e Bashkisë Vau Dejës për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut
- 5.Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9 (nëntë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 0.1732 ha, “Për qëllime shëndetësore,shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi (kampingje, kënde lojërash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj) dhe 0.04 km rrugë për tu lidhur me siperfaqen që do të jepet në përdorim në ekonominë pyjore Koman Karmë.
- 6.Projekt vendim për dhënien me qira të fondit pyjor me afat neri 9 (nëntë) vjet të sopërfaqes pyjore prej 1.95 ha “Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme” në ekonominë pyjore Gomsiqe.
- 7.Projekt vendim për dhënie titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës Z.Dom Nikson Shabani.
- 8.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Rrok Pjeter Rrotani, i dëmtuar nga zjarri me datë 21.07.2024, banor i Bashkisë Vau Dejës.
- 9.Të ndryshme

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes për muajin Gusht 2024, u zhvillua me datë 28.08.2024 ora 15.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 17 këshilltarë, duke përfshirë Znj.Kristjana Kovaçi e cila ishte prezent nepermjet sistemit audioviziv(online) për arsye se e kishte



te pamundur pjesmarrjen fizikisht në mbledhje për arsye të lindjes së fëmijës (vertetuar me certifikate lindje), kjo bazuar ne rregulloren nr.23 date 24.04.2020 “Per organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak Vau Dejes” neni 65.Korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.Znj.Kristjana Kovaçi ju bë e qartë se pjesmarrja e sajë në mbledhje do te jete vetem per nje pike te rendit te dites,nepermjet sistemit SAV, konkretisht per piken e parë, interes per te cilen edhe ajo ka shprehur nepermjet komunikimeve me telefon.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 17 vota Pro.**

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.46 datë 13.06.2023, mbi zgjedhjen e zëvendës kryetarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

Këshilltarëve ju spjegua arsyeja e hartimit te ketij projekt vendimi sepse Znj.Paola Pleshaj, ish zevendes kryetare e keshillit ka humbur mandatin dhe per rrjedhoje duhet te zëvendësohet, si dhe procedura që do te ndiqet per zgjedhjen e zëvendës kryetarit të Këshillit Bashkiak dhe per kete qëllim, komisioni i votimit i ngritur me vkb nr.43 datë 13.06.2023, filloj punen per procesin e votimit i cili sipas ligjit do te bëhet i fshehtë.Fillimisht u kerkua nga grupet politike te këshillit që të bëjnë propozimet per këtë detyrë.Znj.Franga Kola, kryetare e grupit politik P.S.Sh, propozoj Znj.Leonora Prenga si kandidate per zëvendës kryetare të Këshillit Bashkiak Grupet e tjera politike te këshillit, nuk kishin propozime, keshtu që komisioni plotesoj fletet e votimit vetem me nje kandidaturë.U realizua procesi i votimit dhe fituese rezultoj Znj.Leonora Prenga me 16 vota Pro (Theksojmë se keshilltarja znj.Kristjana Kovaçi u shpreh me zë pro kandidatures se paraqitur).Komisioni hartoj procesverbalin e votimit.Znj.Kristjana Kovaçi largohet nga mbledhja, mundesi e cila ishte krijuar nepermjet sistemit SAV.Në sallë mbeten 16 këshilltarë.

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.69 datë 28.09.2023, për ngritjen e komisioneve të Këshillit Bashkaik Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj sqaron se si pasojë e vakances se krijuar nga humbja e mandatit nga ish këshilltarët Z.Afrim Kapidanja dhe Znj.Paola Pleshaj te cilet ishin edhe anetarë të komisioneve te këshillit, lind detyrimi ligjor i zëvendësimit te tyre me këshilltarët e rinj të mandatuar.Ndryshimet jane paraqitur ne projekt vendim me te cilin,jeni te pajisur.

Pyeten këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.Këshilltarët nuk kishin pyetje.



Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 16 vota Pro.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2024.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Brisilda Basha -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se , bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Korrik 2024, te perfitojne 135 familje, me 461.065 leke, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Korrik 2024 janë shpallur fitues, 1.024 familje, me fond 7.699.997 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 461.999 lekë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 16 vota Pro.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:**

Projekt vendim për dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurimit , me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 1 ha pjesë e pasurisë nr.22, Zk nr. 1100, e llojit “Kullotë”, në fshatin Barbullush, pronë e Bashkisë Vau Dejës për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut.

Z.Ervis Shimaj i jep fjelen per te relatuar Z Ndoc Baqli- pergjegjes i zyres aseteve Bashkia Vau Dejes, i cili relaton per keshilltarët se për hartimin e projekt vendimit eshte zbatuar me korrektesi baza ligjore dhe se me date 15.08.2024 është realizuar dëgjese publike me banorët e fshatit Barbullush dhe se te pranishmit kishin shprehur dakortesi per projekt vendimin. Për sipërfaqen e mesiperme e cila do ti nënshtrohet procedures se prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi, do të zbatohet edhe VKM nr.559 datë 29.07.2022 “ Për miratimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 16 vota Pro.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9 (nëntë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 0.1732 ha, “Për qëllime shëndetësore,shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe



argëtimi (kampingje, kënde lojërash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj) dhe 0.04 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonominë pyjore Koman Karmë.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Mark Suli-inxhinjer specialist pranë zyres pyjeve dhe kullotave, Bashkia Vau Dejës, i cili spjeron për këshilltarët se është zbatuar me korrektesi baza ligjore për hartimin e projekt vendimit dhe se me date 08.08.2024 është realizuar dëgjese publike me banorët e fshatit Karmë dhe se te pranishmit kishin shprehur dakortesi për projekt vendimin. Për sipërfaqen e mesiperme e cila do të nënshtrohet procedurës së prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi, do të zbatohet edhe VKM nr.559 datë 29.07.2022 “ Për miratimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” shtojca 1, pika 8/4.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 16 vota Pro.**

#### **Z.Ervis Shimaj lexon pikën e gjashtë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për dhënien me qira të fondit pyjor me afat neri 9 (nëntë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 1.95 ha “Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme” në ekonominë pyjore Gomsiqe.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Mark Suli-inxhinjer specialist pranë zyres pyjeve dhe kullotave, Bashkia Vau Dejës, i cili spjeron për këshilltarët se është zbatuar me korrektesi baza ligjore për hartimin e projekt vendimit dhe se me date 08.08.2024 është realizuar dëgjese publike me banorët e fshatit Mllojë-Gomsiqe dhe se te pranishmit kishin shprehur dakortesi për sipërfaqen e kerkuar për dhënie në përdorim por ato u shprehen se problem do të sjellte rruga që do lidhej kjo sipërfaqe pyjore nga ku sipas tyre ish pronarët e vjeter, nuk do lejonin krijimin e një rruge nepermjet ish pronave të tyre.Ndërsa një pjesë e të pranishmëve kishin shprehur dakortësi për projekt vendimin.

Z.Ervis Shimaj sqaron se ne adresë të këshillit është bërë një ankesë me shkrim nga z.Gledis Laçaj, administrator i nje biznesi turistik pranë sipërfaqes pyjore që përfshin projekt vendimi.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Ermir Tahiri pyet: A e keni parë nga afer këtë sipërfaqe pyjore?

Z.Mark Suli përgjigjet:Patjeter që po sepse aty edhe kemi qenë në dëgjese publike.



Z.Mark Bisha pyet: A bëhet fjalë për pronen apo për rrugë?

Z.Mark Suli pergjigjet: projekt vendimi flet per pronen, problemet e rruges nuk na duhen.

Z.Frano Prenga shprehet:Ne votojmë për pronen qe kerkohet në projekt vendim.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **8 vota Pro, 8 vota kundër, Nuk Miratohet.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për dhënie titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës Z.Dom Nikson Shabani.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalen Z.Elvis Preçi- zëvendës kryetar i Bashkisë, i cili relatton për këshilltarët se me propozim të Kryetarit të Bashkisë bazuar në kontributin dhe vlerat e Z.Dom Nikson Shabani që ka dhënë për 10 vitet e fundit, në ndihmë të familjeve në nevojë në Bashkinë Vau Dejës kërkojmë miratimin me titull “Qytetar Nderi” për Z.Dom Nikson Shabani.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 16 vota Pro.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e tetë të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Rrok Pjeter Rrotani, i dëmtuar nga zjarri me datë 21.07.2024, banor i Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalen per te relatuar Znj. Valjeta Nikaj- pergjegjese e zyres emergjencave civile, Bashkia Vau Dejës e cila spjegon se eshte zbatuar me korrektesi baza ligjore për hartimin e projekt vendimit, duke u bazuar në proces verbalin e konstatimit të gjendjes dhe vleresimit të dëmëve, relacionit teknik të hartuar nga inxhinjeri i grupit të punës, ku vlera totale e dëmit arrin në 589.837 lek si pasojë e zjarrit me datë 21.07.2024.Kërkojmë dakortësi nga ana e juaj si anëtarë të këshillit për dhënie ndihme financiare vleren prej 50% të dëmit 294.918.5 lek.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 16 vota Pro.**

**Pika 8:Të ndryshme.**Znj.Rregjinë Shelqetja sygjeron se jemi në prag të fillimit të sezonit të ri shkollor dhe kerkoj që në shkollat më të afërta të jenë prezent edhe këshilltarët në ditën e hapjes së shkollave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbledhja e datës 28.08.2024 deklarohet e mbyllur nga Kryetari Këshillit pasi nuk kishte pyetje apo diskutime tjera.

**Mbajtësi i Protokollit**

**Sekretari Këshillit**

**Ardian CELEPIJA**



Këshilltarët:

*Enris Shkurti*  
*Melike Zyber*  
*Nela Kopçari*  
*Triana Kula*  
*Enris Tokiri*  
*Floro Kullço*  
*Meglinda Adreia*